



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. \_\_\_\_prot.

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

**“Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar ;**

**Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” .**

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**“Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar ;**

**Dhe**

**Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr. 12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë shkodër dhe institucioneve të varësisë”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2023 , me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9, pika 1.1/a-ç; nenit 54 germa “ç” dhe “dh”; të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; ligjit nr.68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar; VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar, sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër ;

**VENDOSI :**

1. Të miratojë shkrirjen e institucioneve të varësisë: Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore; Teatri “Migjeni”, Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve”, Dega Ekonomike e Kulturës. Këto institucione do të vazhdojnë funksionimin e tyre deri në përfundimin e procedurave ligjore .

2. Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP) si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër me qëllim që të sigurojë administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e gjithë godinave/objekteve dhe institucioneve kulturore, arsimore, shendetesore, sportive dhe cdo objekti i cili është aset i Bashkisë Shkodër. Organizimi i brendshëm, struktura, organika dhe rregullorja do të miratohen me vendim të Kryetarit të Bashkisë.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, bashkia duhet të kryejë procedurat ligjore për transferimin e personelit në institucionin bashkia Shkodër dhe, tek Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP), sipas legjislacionit në fuqi.
4. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar, sipas tabelave nr. 11 dhe nr. 13 bashkengjitur.
5. Të miratojë ndryshimin dhe shtesën në VKB nr.12 datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar sipas tabelave nr. 9 dhe nr.9.1 bashkëlidhur.
6. Për punonjësit/nëpunësit që preken nga ky vendim, efektet financiare si rezultat i shkrirjes së institucioneve të varësisë, do të mbulohen nga fondet e trasheguara në buxhetin e bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë.
7. Efektet financiare për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP, si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër do mbulohen me buxhetin e vitit 2024.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.




Zv. Kryetar  
*Omid Bojleli*

Zv. Kryetar

*Aradin Bekri*


Drejtoria e Bujqesise

P/Alban Selija  



Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe  
Sporteve

Per. Revalino Kryeziu  



Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe  
Shërbimeve Mbështetëse

Arbete Zenej  



Drejtoria e Financës

Blerta Gjocaj  



Drejtoria Analizës dhe Programimit  
Buxhetor

Teuta Hoxha  


Drejtoria Juridike

B. Lajçaj  


Drejtoria Shërbimeve sociale dhe strehimit

Hilmi Kruja  


Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërove

Fida Sullaku  


Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes se  
investimeve të Infrastrukturës

Alfred Lulata  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 19930 prot.

Shkodër, më 20.12. 2023

RELACION

**“Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar ;**

**Dhe**

**Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr. 12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”i ndryshuar**

**Të nderuar këshilltarë,**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.1/a-ç; nenit 54 germa “ç” dhe “dh”; të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; ligjit nr.68/2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar; VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar; araqesim pranë jush relacionin;

1. Për miratimin e shkrirjes së institucioneve të varësisë: Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore; Teatri “Migjeni”, Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve”, Dega Ekonomike e Kulturës.

Këto institucione do të vazhdojnë funksionimin e tyre deri në përfundimin e procedurave ligjore.

Ky propozim vijon në mbështetje të përvojës së viteve të kaluara si dhe pas analizës së bërë, problematikave të evidentuara me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për të pasur një administratë në punë me performancë të lartë.

Drejtoritë e Bashkisë do të krijojnë lidhje vertikale mes specialistëve, drejtorëve dhe Kryetarit të Bashkisë duke patur delegim, realizim dhe monitorim më të mirë të proceseve të punës. Këto institucione varësie do të asimilohen nga Bashkia Shkodër duke integruar punonjësit brenda administratës, me qëllim monitorimin e tyre në lidhje me realizimin e detyrave funksionale që përmbushin.

Për punonjësit/nëpunësit që preken nga ky vendim, efektet financiare si rezultat i shkrirjes së institucioneve të varësisë do të mbulohen nga fondet e trashëguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë

**2. Krijimin i Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP), si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër me qëllim që të sigurojë administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e gjithë godinave/objekteve dhe institucioneve kulturore, arsimore , shendetesore , sportive dhe cdo objekti i cili është aset i Bashkisë Shkodër. Organizimi i brendshëm, struktura, organika dhe rregullorja do të miratohen me vendim të Kryetarit të Bashkisë ;**

Me këtë organizim synojmë përmirësimin e shërbimeve në mirëmbajtjen e objekteve publike në:

- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e qendrueshme të gjithë godinave, në pronësi të Bashkisë Shkodër.
- Fuqizimin, modernizimin dhe mirëmbajtjen, e cdo pajisje, aksesori, rifiniture të infrastrukturës së godines
- Rritjen e sigurisë , cilësisë dhe shërbimit ndaj qytetarëve.
- Përmirësimin e cilësisë së punimeve dhe shërbimeve në infrastrukture përmes administrimit dhe monitorimit të shërbimeve në godinat në varësi të Bashkisë Shkodër gjatë gjithë vitit.
- Hartimi dhe zbatimi i një plani afat mesëm dhe të detajuar mbi detyrat funksionale në interes të komunitetit;
- Përafrimi i strukturës dhe veprimtarisë së Drejtorisë/Ndërmarrjes, sipas modeleve më të mira efçente;
- Rritja e nivelit profesional të punonjësve me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar;
- Përdorimi me efikasitet i burimeve financiare në të mirë të shërbimeve të ofruara për komunitetin.

**Avantazhet :**

- Rritje e cilësisë dhe e sigurisë në funksion të shërbimit të banorëve të Bashkisë dhe Njësive Administrative.
- Reduktim i kostos nëpërmjet menaxhimit efikas dhe kualifikimit të burimeve njerezore për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera dytesore të Ndermarrjes.

- Rritja e kapaciteteve teknologjike dhe ekonomike me krijimin e nje institucioni te vetem duke mundesuar ofrimin e nje sherbimi gjithepërfshirës dhe me te shpejt në të gjithë territorin administrative të Bashkisë Shkodër .
- Efekshmëri në zgjidhjen me të shpejtë të problematikave dhe situatave emergjente që mund të krijohen.
- Përmirësim i cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet administrimit më të mire të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike të Bashkisë dhe të tretëve si dhe një sistem monitorimi të mire organizuar duke krijuar nje standard te njejte.

Përqëndrimi i kryerjes së detyrave (punë publike) në dy njësi shpenzuese si Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike e krijuar me VKB nr. 28 datë 13.09.2023 dhe krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike është një tjetër element që do të japë impaktin e duhur në realizimin eficient të punëve duke ulur edhe kostot në buxhetin e Bashkisë Shkodër .


Përsa parashtruar më sipër , propozojmë të miratoni ;

- shkrirjen e institucioneve të varësisë: Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore; Teatri "Migjeni", Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve", Dega Ekonomike e Kulturës
- krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike (DPMOP),
- ndryshimin në VKB nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës", të ndryshuar, sipas tabelave 11 dhe 13 bashkëlidhur.
- ndryshimin dhe shtesën në VKB nr.12 datë 20.07.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë", të ndryshuar sipas tabelave 9 dhe 9/1 bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkepunimin!

**KRYETAR**

**Benet BECI**



Tab. 9

**Niveli i pagave për punonjësit**  
**"DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE"**  
**( VKM nr. 328 dt. 31.05.2023)**

Emertimi	Arsimi i larte					Arsimi i mesem			
	Paga baze mujore								
	Kategoria	Shtesa për Pozicion					Klasa	Niveli minimal	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	76 500	85 500	94 500	103 500	112 500			2%
Drejtor Drejtorie	II-b	68 000	73 750	79 500	85 250	91 000			2%
Përgjegjës	III-a	40 200	50 225	60 250	70 275	80 300			2%
Përgjegjës	III-a/1	37 000	46 225	55 450	64 675	73 900			2%
Specialist	III-b	34 900	43 675	52 450	61 225	70 000			2%
Specialist	IV-a	32 700	38 525	44 350	50 175	56 000			2%
Specialist	IV-a	32 700	38 525	44 350	50 175	56 000			2%
Specialist	IV-b	30 600	33 950	37 300	40 650	44 000			2%

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën 2%, jepet pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi shtesë e nivelit të kualifikimit . Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën 1 %, të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.Përshtohen nga kjo llogaritje vitet të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

"Specialistët", "Përgjegjësit e sektorit" apo "Drejtorët e drejtorive", të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit "Master i shkencave"/"Master profesional"/ Bachelor" apo të barasvlershëm me ta, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni" apo "Shkenca kompjuterike" "Teknologji informacioni", "Informatikë ekonomike" dhe "Inxhinieri matematike informatike", përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën: - 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të bashkive me mbi 100 001 banorë.



**"DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE"**  
( VKM nr. 326 dt. 31.05.2023)

Emertimi	Vendndodhja	Niveli Maksimal I/E zgjedhur, emruar	Arsimi i larte		Arsimi i mesem		
			Paga baze mujore				
			Kategoria	Shtesa për Pozicion	Klasa	Niveli minimal	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
punonjes shërbimi, sanitare, punëtor terreni, punëtor, punonjes me kontrate, roje, evidencier	Institucione varesie				I	40 000	1%
punëtor skene, mekanik, motorist, elektrikist, tomitor, saldator, axhustator, llamarinist, ndriçues mixer+ elektricit, hidraulik, bojaxhi, marangoz, roje, Shofer autoveture, punëtor i kualifikuar	Institucione varesie				II	41 000	1%
roje, teknik i objekteve sportive, kaldaist, Magaznier dhe Protokollist-arkivist,	Institucione varesie				III	41 800	1%
punonjës ngarkim- shkarkimi, shofer, magaznier	Institucione varesie				IV	42 500	1%
teknik ndertimi	Institucione varesie				V	42 800	1%
Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme, Manovrator autoshkalle, Shofer, anketues, teknik i mirëmbajtjes, teknik i mesëm	Institucione varesie				VI	43 200	1%
Manovrator fadrome, shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe i mjeteve speciale,	Institucione varesie				VII	43 600	1%
Teknik për mirëmbajtje ndërtesash, Llogaritar i mesem, Elektriçist i kualifikuar	Institucione varesie				VIII	44 100	1%

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën 2%, jepet pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit . Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie

Shtesa për vjetërsi në punë e percaktuar në masën 1 %, të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.Përjashtohen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

**KRYETAR**

**Benet BECI**



NUMRI I PUNONJESVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Viti 2024

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	2141001	583	20
Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike		126	
Drejtoria e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike		228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	42	
<b>TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta )</b>		<b>979</b>	<b>20</b>
Gjendje Civile - Efektet financiare me transferte te kushtezuar)	2141001	20	
<b>TOTALI</b>		<b>999</b>	<b>20</b>

Nga 1 janar 2024 deri perfundimin e procesit të transferimit në Bashkinë Shkodër

Institucioni	Kodi i institucionit	Numri i punonjesve të miratuar 2023	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	2141001	350	
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	2141043	34	
Dega Ekonomike e Kultures	2141013	35	
Teatri "Migjeni"	2141017	38	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	2141010	229	
Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike		105	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	2141031	247	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042	42	
<b>TOTALI</b>		<b>1080</b>	
Gjendje Civile - Efektet financiare me transferte te kushtezuar)	2141001	20	
<b>TOTALI</b>		<b>1,100</b>	

KRYETAR

Benet BECI

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër. Ëmb: [beb@bashkashkoder.gov.al](mailto:beb@bashkashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkashkoder.gov.al](mailto:info@bashkashkoder.gov.al)



**Emertimi i njesive shpenzuese VITI 2024 - BASHKIA SHKODER**

Viti 2024

Institucioni	Kodi i institucionit
Bashkia Shkoder	2141001
Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike	
Drejt e pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042

Nga 1 janar 2024 deri perfundimin e procesit të transferimit në Bashkinë Shkodër

Institucioni	Kodi i institucionit
Bashkia Shkoder	2141001
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	2141043
Dega Ekonomike e Kultures	2141013
Teatri "Migjeni"	2141017
Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	2141010
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	2141031
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	2141042

KRYETAR

Benet BECI

